



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

Betohet Imri Ahmeti i rizgjedhur për të tretën herë kryetar i Komunës së Lipjanit



Daut Azemi zgjedhet edhe në këtë mandat Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Gjatë seancës inauguruese të Kuvendit Komunal të Lipjanit, pas procesit të betimit të kryetarit të komunës dhe 31 këshilltarëve të zgjedhur në zgjedhjet e 17 Tetorit të këtij viti Daut Azemi u zgjodh edhe në këtë mandat kryesues i Kuvendit Komunal të Lipjanit.



Lipjani shpërblehet me grant prej 422.351 mijë euro për mjedis të pastër

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëfinancim me organizatën gjermane GIZ dhe Bashkimin Europian, kanë shpërblyer Komunën e Lipjanit me grant me vlerë prej 422.351 mijë euro.



Kryetari Komunës së Lipjanit ka përcjellë punimet që janë bërë në objektin e çerdhes në fshatin Gadime.

Me këtë rast kryetari Ahmeti tha se është kënaqësi e veçantë të shohësh këtë infrastrukturë objekte me standarde të larta dhe kushte moderne, i cili do të shërbejë për edukimin e fëmijëve.



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me Nona Zicherman nga UNICEF dhe përfaqësues të tjerë kanë bërë Përurimin i Qendrës me bazë në komunitet në Magure



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me Mimoza Shahini drejtoreshë e Qendrës për Shërbime Humane dhe Zhvillim në Kosovë kanë bërë Përurimin i Qendrës me bazë në komunitet në Shalë të financuar nga UNICEF



Policia e Kosovës , në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimimit ne Lipjan gjate kesaj jave kanë implementuar projektin 'Së bashku kundër bullzimit në shkolla'



Rekord i ri në realizimin e të hyrave vetanake buxhetore

Është shënuar një rritje e të hyrave vetanake buxhetore ku të planifikuara për vitit 2021 kanë qenë 1,907,316.00€ deri me datën 01.11.2021 është tejkaluar planifikimi në shumën prej 165,748.72 € ose në total të hyrat vetanake kanë arritur shumën prej 2,073,064.72 €.



REKORD I RI NË REALIZIMIN E TË HYRAVE VETANAKE BUXHETORE



Planifikimi për vitit 2021 ka qenë

1,907,316.00€

Deri me datën 01.11.2021 është tejkaluar planifikimi në shumë prej **165,748.72 €** ose në total të hyrat vetanake kanë arritur shumën prej **2,073,064.72 €**.

Planifikimi i të hyrave buxhetore është realizuar **100%** me datën 18.10.2021. Edhe këtë vit Lipjani po shënon progres të jashtëzakonshëm në realizimin e të hyrave buxhetore.

Në kuadër të festave të nëntorit Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë bëri homazhe dhe ka vendosur buqeta lulesh pranë shtatores së Komandantit Legjendar "Adem Jashari" në qytetin e Lipjanit për të përkujtuar sakrificën e tyre për liri



'PërSHËNDETje' nga Gadimja është mbajtur aktiviteti, ku banorët vizituan tendat informative për të mësuar se si të kenë shëndet më të mirë, duke ndjekur këshillat e dhëna nga stafi shëndetësor aty për aty i organizuar nga OJQ Zvicerane AQH në kuadër të projektit "Kujdesi shëndetësor i Qasshëm dhe cilësor" në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit



Me moton “Nëse jo tani, kur?” edhe në Komunën tonë u mbajt aktiviteti për të shënuar Ditën ndërkombëtare të Diabetit



Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me projektet me AQH -në, kanë zhvilluar aktivitetin me moton “ mjedis i shëndetëshëm, njerëz të shëndetëshëm” në oborrin e AMF - Kraishtë u bo punë vullnetare ngjyrosja e rrethojave të kësaj ambullante



Është bërë nënshkrimi i kontratave për 50 përfitues për hapjen e puseve të ujit të pijes në Komunën e Lipjanit.

Nënkryetari Komunës së Lipjanit, Fauz Xhemajli ka falënderuar organizatën Qatar Charity për punën e madhe që po bënë në Lipjan, ku ka bërë hapjen e shumë puseve të ujit të pijes.



Filloi fushata "16 Ditët e Aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas"

Këshilli Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe në Baza Gjinore i kryesuar nga Fjolla Ibrahim i mbështetur nga zyra e kryetarit të komunës, në kuadër të aktivizimit 16-ditor të fushatës kundër dhunës në baza gjinore sot ka filluar me aktivitete të shumta përcjellëse, duke marshuar nga oborri i objektit komunal drejt sheshit në qytetin e Lipjanit për ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin e qytetarëve se dhuna ndaj gruas dhe familjes është akt që shkel të drejtat e njeriut.



Nën patronatin e Kryetarit Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, kujdesur nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport është mbajtur program kushtuar 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, shfaqja e baletit nga shkolla e baletit Angel-Lipjan.

Ky program është përgatitur nën drejtimin artistik të Vlora Prizreni dhe Sead Vuniqi



Në kuadër të aktiviteteve për nderë të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit, të organizuar nga Komuna e Lipjanit gjegjësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në ambientet e Bibliotekës së qytetit është hapur ekspozita nga shkolla e artit Picasso.





VAKSINOHU!

✦ #Bashkëiadalim



LIPJAN



KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM



BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET